



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 09 Qershor 2021

Nr: 395

**VENDIM**

**PËR**

**PLOTËSIMIN E VAKANCËS NË KËSHILLIN E BASHKISË MEMALIAJ, ME  
KANDIDATIN NGA LISTA SHUMEMËRORE E PARTISË SOCIALISTE TË  
SHQIPËRISË, ZJ. ESMERALDA HASAN SHAHA (XHAFERI)**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 dhe 164, pikat 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” dhe të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pasi shqyrtova dokumentacionin përkatës,

**VËREJ:**

Me shkresën nr. 556/3 prot., datë 22.04.2021, këshilli i bashkisë Memaliaj, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari, z. Petrit Latif Shaha, propozuar nga Partia Socialiste e Shqipërisë.

Referuar nenit 164, pika 2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, kandidati vijues nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, për këshillin e



bashkisë Memaliaj të cilit i kalon mandati i këshilltarit, është kandidati me numër rendor 21, zj. Donika Myslym Manai.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me shkresën nr. 4663 prot., datë 28.04.2021 ka njoftuar zj. Donika Myslym Manai, me kërkesë për plotësim dokumentacioni.

Nëpërmjet e-mailit zyrtar, datë 30.04.2021, këshilli i bashkisë Memaliaj ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve që zj. Donika Myslym Manai është punonjëse në bashkinë Memaliaj, me detyrë edukatore. (bashkëngjitur e-mailit vërtetimi i lëshuar nga Bashkia Memaliaj).

Bazuar në nenin 47, pika 1, shkronja “c” e ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”i ndryshuar, konstatohet se kandidatja e mësipërme është në kushtet e papajtueshmërisë për marrjen e mandatit të këshilltarit.

Në këto kushte, referuar nenit 164, pika 2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, kandidati vijues nga lista shumemërore e Partisë Socialiste e Shqipërisë, për këshillin e bashkisë Memaliaj, të cilit i kalon mandati i këshilltarit, është kandidati me numër rendor 23, zj. Esmeralda Hasan Shaha (Xhaferi).

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me shkresën nr. 4865 prot., datë 04.05.2021 ka njoftuar zj. Esmeralda Hasan Shaha (Xhaferi), me kërkesë për plotësim dokumentacioni.

Referuar nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse, për këshillin bashkiak, të cilit i takon të marrë mandatin e këshilltarit për vendin vakant.

Kandidati për këshilltar, përcaktuar në bazë të listës shumemërore, të subjektit Partia Socialiste e Shqipërisë, ka plotësuar dhe depozituar formularin e vetëdeklarimit, me numër 2164 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik, ku përfshihet dhe funksioni i këshilltarit të bashkisë.

Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit, të kandidatit për anëtar, zj. Esmeralda Hasan Shaha (Xhaferi), në këshillin e bashkisë Memaliaj, rezulton se: Në rubrikën I. “TË DHËNA PERSONALE”,



PIKAB, “Gjenealitetet të mëparshme” të Formularit të Vetëdeklarimit, subjekti vetëdeklarues ka deklaruar gjenealitetet e saj dhe është shprehur se ka ndryshuar mbiemrin nga “XHAFERI” në “SHAHA”.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe Kreut V, pika 2, shkronja “b” dhe pika 3, shkronja “c”, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015”, me shkresën nr. 5453 prot., datë 25.05.2021, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe me shkresën nr. 5452 prot., datë 25.05.2021, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore për kandidatin për anëtar, zj. Esmeralda Hasan Shaha (Xhaferi), në këshillin e bashkisë Memaliaj, që ka dorëzuar formularin e vetëdeklarimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si dhe ka bërë publikimin e formularit të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, me shkresën nr. 1987/1 prot., datë 04.06.2021, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e të dhënave për kandidatin për anëtar në këshillin e bashkisë Memaliaj, zj. Esmeralda Hasan Shaha (Xhaferi), e cila rezulton se nuk ka ndryshime në përbërësit e gjendjes civile.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, me shkresën nr. 5390/1 prot., datë 28.05.2021 ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatin për anëtar zj. Esmeralda Hasan Shaha (Xhaferi), në këshillin e bashkisë Memaliaj, e cila rezulton se nuk ka shënime në sistem.

Referuar pikës 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, konstatoj se, të dhënat e kandidatit për anëtar zj. Esmeralda Hasan Shaha (Xhaferi), në këshillin e bashkisë Memaliaj, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e këshilltarit.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 dhe 164, pikat 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në nenin 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” dhe në Kreun V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e



rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

### **V E N D O S:**

1. Zj. Esmeralda Hasan Shaha (Xhaferi), kandidat për anëtar në këshillin e bashkisë Memaliaj, nuk përfshihet në kushtet e moszgjedhshmërisë për ushtrimin e funksionit.
2. Plotësimin e vakancës në këshillin e bashkisë Memaliaj, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, zj. Esmeralda Hasan Shaha (Xhaferi).
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**

